- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-10372-5-2-1/C1009

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10 % e vlerës së kontratës në kohëgjatje prej 60 ditësh, apo shprehur nominalisht 2.290.47€</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [10] ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë max 30 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës, respektivisht deri më: 20.12.2024. Cdo tejkalim apo vonesë pas kësaj date do të zbatohen penalet sipas pikës 19.1 të KVK-së.
	17.2	Përfundimi i të gjitha Punëve do të jetë 30 ditë kalendarike.

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Pagesa	19.2	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheret e kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet Milaim Qeriqi dhe Enver Elshani, ndërsa MDMK Besart Zejnullahu.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% te vleres se kontrates per 1 vit apo 12 muaj i cili do te perdoret per permirsim te defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM të puneve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR , sipas manualit-doracakut të KRPP-së, i publikuar më dt 08.07.2024,
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës ne forme te sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar pas CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra per Ndermjetesim prane Ministrise se Drejtesise
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykata themelore e vendit</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i>

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

HARTIMI I PROJEKTIT PER NDARJEN E KTHINAVE PER OBJEKTIN ADMINISTRATIV

LOKACIONI: OBJEKTI KOMUNES - LIPJAN

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL LIPJAN

VËREJTJE:

Materialet e propozuara në paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv.

Perpara ekzekutimit te ketyre pozicioneve duhet paraprakisht te prezentohen mostra, certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesi.

Ne te gjitha pozicionet perfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI, PUNIMI, TEK PASTRIMET DHE DEMOLIMET E GERMIMET TE PERFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI. Demtimet eventuale te mureve, dyshemese, driteve, dyerve, etj qe jane pjese egzistuese e objektit gjate periudhes se ekzekutimit te punimeve mbetet pergjegjesi e operatorit ekonomik. Per cdo ndryshim te konsultohet projektanti paraprakisht, te meret aprovim prej tij.

1	PUNËT NDËRTIMORE				
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/N JËSI	SHUMA
1.01.01	Pergatitja e kompanise dhe bartja e paisjeve qe mundesojne realizimin e punimeve ne vendpunishte. Ne cmim te perfshihet dhe sigurimi i vendpunishtes per realizimin e punimeve ne menyren me te sigurte (sigurimi i punishtes).	komplet	1	380.00 €	380.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e EC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	865.60 €	865.60 €
TOTAL POZICIONI				1.01	1,245.60 €

1.02	PUNËT E DEMOLIMIT DHE DEMONTIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/N JËSI	SHUMA

1.02.01	Te behet largimi i perkoheshem i inventarit (karrika, tavolina, rafta, ormane, neper zyre etj.) ne nje hapesire tjeter te percaktuar nga komuna deri ne perfundimin e punimeve dhe pas perfundimit te punimeve ne koordinim me menaxherin e kontrates te kthehen ne objekt. Demtimet eventuale gjate largimit/transportit jane pergjegjesi e pune kryesit.	komplet	1.00	270.00	270.00
1.02.02	Te behet demolimi i deres hyrese nga alumini me dimensione 200x310 cm, dera ekzistuese eshte ne kuader te fasades gjysmestrukturale nga alumini, ne cmim perfshihet transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	komplet	1.00	105.65	105.65
1.02.03	Te behet demolimi i pllakave te gipsit ekzistues per sistemin e tavanave te varura me dimensione 60x60 cm. Demolimi i pllakave te demtuar dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance. Perzgjedhja e pllakave te demtuara behet ne koordinim me menaxherin e kontrates. Gjat demolimi te pllakave te demtuara duhet te ruhet konstruksioni ekzistues ne te kunderten cdo demtim eventual eshte pergjegjesi e pune kryesit.	m²	110.00	3.73	410.30
1.02.04	Te behet demontimi i perdeve shiritore ekzistuese si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance, ne cmim te perfshihet adaptimi dhe rimontimi i perdeve pas perfundimit te punimeve/ pozicioneve perkatese.	m²	75.00	6.50	487.50
1.02.05	Te behet geryeja e suvatimit ekzistues ne pozicionet e demtuara nga lageshtia deri ne shtresen e forte/ bllok. Ne cmim perfshihet transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	m²	60.00	3.95	237.00
1.02.06	Te behet demolimi i trupave ndricues ekzistues 60x60 cm. Verejtje: Instalimi ekzistues duhet te ruhet ngase do te perdoret me pastaj.	cope	74.00	3.20	236.80
1.02.07	Te behet demolimi i dyerve te nyjet sanitare (dera qe hyne tek nyjet sanitare dhe tek banjo e pare qe shnedrohet ne nje sanitare per persona me nevoja te veqanta), te parashihet edhe largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga komuna.	cope	2.00	93.50	187.00
1.02.08	Te behet demolimi i elementeve te sanitarise (ec guacat + fontana, lavamanet) se bashku me gypat vazhdues, ek ventilat, rubinetat dhe elementet tjera percjellese	cope	12.00	17.30	207.60
TOTAL POZICIONI				1.02	2,141.85 €

1.03	PUNËT E GIPSKARTONIT DHE SUVATIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/N JËSI	SHUMA
1.03.01	Te behet furnizimi me material si dhe punimi i mureve nga gipskartoni. Gjersia totale e mureve te jete 15 cm dhe ne cmim jane te perfshira te gjithë materialet si ne vijim: - Pllakë gipskartoni 12mm - Pllakë gipskartoni 12mm - Konstruksioni adekuat metalik 100mm me ndarje vertikale cdo 60 cm, dhe horizontaleve metalike (shtanguese) sipas standareve te ekzekutimit. - Hapsira ne mes te konstruksionit te jete e mbushur me leshguri t=10 cm, 50kg/m³ - Pllakë gipskartoni 12mm - Pllakë gipskartoni 12mm Referohuni detalit D-01 - Detali i mureve gipskartoni	m²	125.70	21.30 €	2,677.41 €
1.03.02	Te behet furnizimi dhe montimi i pllakave te gipsit me dimensione 60x60 cm per sistemin e tavaneve te varura. Pllakat duhet te jene identike apo te ngjajshme me ekzistueset, perzgjidhja e tyre behet ne koordinim me menaxherin e kontrates. Konstruksioni eshte ekzistues (eventualisht nese duhet ndonje perforcim apo zevendesim me profil te ri).	m²	110.00	6.95 €	764.50 €
1.03.03	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve te gipskartonit dhe mureve te demtuara nga lageshtia në të dy etazhat me material të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çimento+agregat) ose material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaç sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaçit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rrjetë armimi dhe shirit vetngjites për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukthtarisë me folie të PVC-së deri në finalizimin e suvatimit dhe ngjyrosjes si dhe rrjeta e PVC-së me fije qelqi për perforcimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin.	m²	340.0	3.85	1,309.00 €
1.03.04	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve me dy shtresa glet-masë (secila me trashësi së paku 1 mm) RÖFIX 225 ose material të ngjashëm.	m²	340.0	1.95	663.00 €



1.03.05	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve ekzistuese dhe mureve (gipskartoni te punuara) të patinuara me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastrimit si StoColor Puran. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyerje bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj. Për më shumë të dhëna rreth ngjyrave dhe aplikimit të tyre shih përshkrimin teknik dhe broshurat e materialeve.	m²	1480.0	1.62	2,397.60 €
TOTAL POZICIONI			1.03	7,811.51 €	



1.04	PUNËT E ZDRUKHTARISE				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve të punuara nga profilet e aluminit sipas skemave dhe specifikimeve në projekt duke përfshirë të gjitha mjetet e lidhjes dhe fiksimit dhe shumën montuese nga PU. PRODHUESI ALUMIL ose prodhues i cilësisë së njëjtë. SISTEMI SMARTIA M11000 profile alumini të ekstruduar me izolim termik 3 EPDM goma izoluese DRITARET Korniza fikse: M11010 62.5x58 mm Krahu i dritares: M11434 70.0x75 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90 mm Profili lëvizës T: M11058 Listella e kornizës: M11439 Listella e krahut: M15110 ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DRITAREVE Mekanizmi: ROTO AL Mekanizëm për dritare alumini me hapje në aksin horizontal dhe vertikal Mënteshat: ROTO AL Ngjyra: Silver Anodised Dorezat: ROTO Line Tipi me çelës: Lockable 100 Nm Ngjyra: Silver Anodised DYERT tipologjia me hapje brenda Korniza fikse: M11086 67.7x68.0 mm Krahu i derës: M11082 62.5x90.4 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90.0 mm Profili lëvizës T: M11156 Parapeti i derës: M11142 Listella e kornizës: M11453 Listella e krahut: M11453				


	DYERT tipologjia me hapje jashtë Korniza fikse: M11088 62.5x68.0 mm Krahu i derës: M11084 62.5x90.4 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90.0 mm Profili lëvizës T: M11158 Parapeti i derës: M11142 Listella e kornizës: M11084 Listella e krahut: M11453 Pragu i ulët: M11184 ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DYERVE Mekanizmi: ROTO SAFE H H600 Bravë me mekanizëm për mbyllje mekanike shumëpikëshe Mëntesha: ROTO SOLID B Mëntesha dypjesëshe Ngjyra: Silver Anodised 3 copë për krah Brava/Mbyllja: Euro cilindër mesingu me çelës Tipi me 6 gjilpëra Tipi : Anti Snap Dorëzat: Inox Tipi i levës me kapak në formë rozetash me profil për cilindër KOMPONENTAT E PËRBASHKËTA Qelqi: Transparent Termopan 4+16+4mm/Loë-E + Argon Paneli termoizolues: STADUR FB-4 Aluminium Sandëich elementi nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje EPS t=24 mm E hirtë Anodised - RAL 7016 Ngjyra e profileve: E hirtë Anodised - RAL 7016 Izolimi akustik: 47 dB UF=2.3 $\frac{W}{m^2K}$ VËREJTJE: Të gjitha profileve të dyerve dhe dritareve pas montimit dhe ngurtësimit të shumës montuese duhet tu largohen shiritat mbrojtës dhe të pastrohen nga pjesët ngjifëse sipas udhëzimeve të prodhuesit.				
1.04.01	POS D01 - Derë dykrahëshe me mbidritë Kahu i hapjes së dyerve: Jashtë Dimensionet: 200x310 cm. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik dhe shufër për hapje në shtytje "Panic bar". Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë D-09.	cope	1.00	253.60 €	253.60 €
1.04.02	POS E01 - Dritare e kombinuar - 1 hapje rreshqitese (120x70 cm) dhe 4 pjesë tjera fikse, cila vendoset në lartësi(parapet) nga dyshemeja h=90.0cm. Dimensionet totale: 250x150 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë D-08. Pozicionimi i dritares bëhet tek pjesa e kontrollës/ hyrjes dhe montimi bëhet në konstruktionin e murit të punuar nga plakati e gipskartonit.	cope	1.00	198.60 €	198.60 €
1.04.05	POS E01 - Dritare e kombinuar - 2 hapje dhe 3 pjesë tjera fikse Dimensionet totale: 510x240 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë. Pozicionimi i dritares bëhet në sallën e sporteve në katin perdhese ku ndodhet arkiva.	cope	1.00	390.50 €	390.50 €

1.04.07	POS FFurnizimi dhe montimi i fasadës gjysëmstrukturale me 5 ndarje vertikale dhe 4 ndarje horizontale, ne kuader te se ciles integrohen 2 dyer me dimensione 100x240 cm dhe 200x240 cm në hyrjet kryesore të objektit tek pjesa e erembrojtjesit.Sistemi: M6 Solar Standard me ndërprerje të urës termike dhe kapak për mbulimin e fugave.Profilet vertikale: 55x115 mmProfilet horizontale: 55x53 mmKapaku: Kënddrejtë 55x16 mmQelqi: Transparent/Termopan 6+14+4mm/Loë-E + ArgonNgjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt.Dimensionet: 510x455 cm.Në çmim të përfshihen të gjitha elementet shtesë për lidhje me fasadën termoizoluese dhe për evitimin e urës termike tek bashkimi me derën rrëshqitëse.Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë D-03 .	m²	24.20	112.60 €	2,724.92 €
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme të veshura me llamarinë çeliku. Paneli: OIT - panel nga ashklat e drurit me trashësi 40 mm i veshur me llamarinë 0.8 mm. Korniza e derës: dypjesëshe - profili 21180 me trashësi 1.5 mm (opcionale - profili teleskopik 21168) Profili i mesëm: çelik - tipi 41102 Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak në formë rozete Mënteshat: tipi VX - 3 pjesësh me ngjyrë kromi mat Brava-Mbyllja: Euro cilindër mesingu me çelës. Tipi me 6 gjilpëra Ngjyra: Përcaktohet ne koordinim me menaxherin e kontrates				
1.04.08	POS DD02 Derë druri e brendshme njëkrahëshe Dimensionet: 90x210 cm.	cope	5.00	176.30 €	881.50 €
1.04.09	POS DD03 Derë druri e brendshme njëkrahëshe Dimensionet: 100x210 cm. Dyeri jane te vendosura tek nyjet sanitare(njera tek hyrja tek nyjet sanitare dhe tjetra tek kthina qe do te perdoret per PAK).	cope	1.00	178.80 €	178.80 €
TOTAL POZICIONI			1.04	4,627.92 €	

1.05	PUNËT E INVERTARIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA

1.05.01	Te behet furnizimi me material si dhe recepsioneve modulare nga MDF me trashësi 18 mm dhe ndarje xhami te temperuar me trashësi 5 mm ne pjesen balllore, ne cmim jane te perfshira metalike me dimension 50x50x2 mm ne treg per ndarja e xhamit. Dimensionet e receptionit tavolinen anesore dhe pullin jane 195x153 cm dhe lartesi totale duke perfshire dhe krahoret Referohuni tek detali D-02. 	cope	5.00	101.56 €	507.80 €
1.05.02	Te behet furnizimi i uleseve statike nga nikel dhe me konstrukcion metalik sipas detajit D-03. Gjerësia: 49 cm, Lartësia: 83 cm, Thellësia: 51 cm. 	cope	2.00	36.80 €	73.60 €

1.05.03	Te behet furnizimi dhe montimi i tavolina trashesi t=18 mm me dimensione 140x60 cm dhe me konstrukcion metalik []H ngjyra percaktohet ne koordinim me mena sipas detalit D-05 	cope	2.00	51.35 €	102.70 €
1.05.04	Te behet furnizimi dhe montimi i tavolina trashesi t=18 mm me dimensione 180x60 cm dhe me konstrukcion metalik []H ngjyra percaktohet ne koordinim me mena sipas detalit D-06 	cope	1.00	73.25 €	73.25 €

1.05.05	Te behet furnizimi dhe montimi i uleseve rrot me materiale te percaktuara si ne vijim: Materiali Lëkurë artificiale (PU/poliuretan), sf (polipropilen), dru i shtresuar, poliamid, çelik Ulësja: Lëkurë artificiale (PU/poliuretan), sfur shtresuar, Pas: Lëkurë artificiale (PU/poliuretan) shtresuar, Mbështetësja për duar: PP (polipropil) Poliamid Ulësja Pëlhura: PU (poliuretan), Sfungjeri: Sfu Dendësia e sfungjerit: 60 kg/m³ Mbështetësja për duar Pëlhura: PP (polipropil) Funkioni Rrota me fërkim, Ngritje me gas, Bc Përmasa (montuar) Gjerësia: 57 cm, Lartësia Thellësia: 64 cm Lartësia e ulëses 42-52 Thellësia e ulëses 41 Çertifikata shëndetësore dhe e mjedisit FSC cope Pesha 13 kg sipas detalit D-07	5.00	125.80 €	629.00 €
				
TOTAL POZICIONI			1.05	1,386.35 €

1.06	PUNËT E NDRYSHME				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Te gjitha pajisjet e sanitarisë duhet te jenë të kompletuara me aksesore, gypa, gomina, lidhëse, kthesa, furnizimin me energji elektrike (sipas nevojës), kapakët dhe te gjitha elementet e nevojshme qe pozicioni te jete i kompletuar/ funksional. Te gjitha pajisjet e sanitarisë duhet te jenë me certifikate te kualiteti sipas TE-EN ISO 9001:2000 dhe te punohen sipas udhëzimeve nga prodhues te certifikuar, gjithashtu tu bashkëngjiten certifikate/ flete garancioni minimum 2 vite.				
1.06.01	Furnizimi, transporti dhe montimi i Durëlarësve nga porcelani i klasa e parë me dim. 55x45cm te varur ne mure per persona standard-te rritur. Ne çmimi te llogarite, sifoni nga inoksi, aksesoret, pjesët lidhëse komplet, montimi i pasqyrës 15cm mbi durëlarës, lartësia e pasqyrës 70cm dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogaria behet për cope.	copë	4.0	58.30 €	233.20 €

1.06.02	Furnizimi, transporti dhe montimi i Rubineteve (krojeve) mekanike për ujë të ftohtë dhe të nxehtë nga kromi klasa e parë. Në çmimi të llogariten aksesoret, pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogaria behet për cope.	copë	4.0	16.50 €	66.00 €
1.06.03	Furnizimi, transporti dhe montimi i ËC-ve guacave së bashku me rezervuarin e ujit të montuar në gaucë dhe kromin për pastrim, gaucë nga porcelani klasa e parë, Geberit dimensionet standarde për persona të rritur. Në çmimi të llogariten, rubineta e ujit për pastrim, EK vetilat, pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni. Llogaria behet për cope.	copë	7.0	75.50 €	528.50 €
